



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0794

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092), si dhe nenit 29 dhe 31 të Rregullorës së Punës së OSHP-së 01/2020, e amendamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërjen nga Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Referues dhe Vjosa Gradinaj Mexhuan-Anëtare duke vendosur sipas ankesës së operatorit ekonomik (OE) “Security Code” Sh.P.K, kundër njoftimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve të KPSH” me nr. të prokurimit: "616-23-5765-2-1-1", të Komunës së Prishtinës në cilësi të autoritetit kontraktues (AK), më 12/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e “Security Code” Sh.P.K me nr. 2023/0794, e datës 13/10/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizike i objekteve të KPSH” me nr. të prokurimit: "616-23-5765-2-1-1", të Komunës së Prishtinës në cilësi të AK, ndërkaq aktiviteti i prokurimit ANULOHET në tërësi.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me 08.06.2023 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05, lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurimi fizik i objekteve të KPSH” me nr. të prokurimit: "616-23-5765-2-1-1".

Me datën 27.09.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “King Security” Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 528,000.00 €.

Me 29.09.2023, OE “Security Code Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pazuar kërkesën për rishqyrtim.

Lidhur me këtë aktivitet prokurimi, me datën 13.10.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Security Code Sh.P.K.” me numer protokollit Nr. 794/23.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Lidhur me ket aktivitet prokurimi OSHP ka pranuar edhe nje ankese me numër protokollit 807/2023, ku pas pranimit të Raportit të ekspertit shqyrtues, Autoriteti Kontraktues/Komuna e Prishtinës dhe OE”Rojet e Nderit” ishin pajtuar me Raportin e Ekspertit Shqyrtues që lënda të kthehet në Rivlersim, OSHP, lidhur me këtë ka publikuar vendimin procedural për Pajtim, të Palëve nr.807/2023.Mirpo Paneli sipas një ankese tjetër të pranuar lidhur me ket aktivitet objekt shqyrtimi i kësaj lende nr.794/2023, bazuar ne shkeljet e evidentuara nga AK, ka vendosur ta anuloj në tërsi aktivitetin e prokurimit, me arsyetimin si në vijim.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin shqyrtues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik OE “Security Code” Sh.P.K si në vijim:

Pretendimi i parë (I), Ankuesi pretendon se: “Argument: Neni 7 - Me datë 06.10.2023 kemi pranuar vendimin se kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar pa ndonjë shpjegim të mjaftueshëm dhe të dokumentuar, dhe duke mos u përgjigjur në të gjitha pretendimet tona ankimore sipas LPP dhe Rregullores 001/2022, ku kemi dëshmuar dhe argumentuar se OE “King

Security”, “Rojet e Nderit” dhe “SAS”, janë të papërgjegjshëm respektivisht kanë vënë në lajthitje AK me dokumentet e paraqitura. Në bazë të nenit 7 par.2 të LPP shpjegohet se: “Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik”. Ne kuptim të këtij neni vërejmë se ka pasur indikacione se OE fitues është trajtuar ndryshe dhe nuk ka pasur mundësi të vlerësimit të barabartë në këtë proces tenderimi e posaçërisht me OE fitues duke ra në kundërshtim me vete kriteret e DT të shpallur nga AK. Ky vlerësim ka dëmtuar konkurrencën e drejtë dhe vërehet se oferta jone nuk është vlerësuar drejt dhe në harmoni dhe përputhshmëri me kriteret dhe specifikimet teknike të DT dhe në këtë rast ka krijuar një disavantazh me ofertat tjera duke na shpallur si tenderues të pasuksesshëm. Nuk është e qartë se si arrihet në përfundimin se OE fitues edhe pse është nën prag me çmimin e ofertuar (çaktimi pagës për punëtor prej 294.00€ bruto baze me të gjitha shtesat tjera të përcaktuar me Ligjin e punës në fuqi të caktuara në FTD tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 po ashtu është e specifikuar edhe tek Specifikimet Teknike të Detyrueshme Aneksi 1 për të nxjerrur numrin e punëtorëve duke kalkuluar sipas UA Nr.09/2017) është shpallur fitues nga shqyrtimi në fazën e vlerësimit, duke lënë zbrazëti për dyshime dhe mungesë të besimit në procesin e seleksionimit. Është e evidente fakti që disa aplikues janë përballur me kritere të cilat i kanë krijuar përmbysje të njëjtësisë në trajtim dhe si rrjedhojë ka favorizuar disa ofertues mbi të tjerët dhe në cilësinë e ofertës së paraqitur nga ne. Gjithashtu, vlerësojmë se oferta fituese nuk ka përmbushur të gjitha detyrimet e specifikuar në DT, nga i cili fakt mund të rrezikohet siguria dhe integriteti i objekteve shëndetësore të Komunes së Prishtinës për shkak të mosarritjes së përmbushjes së kriterëve që rrjedhin nga DT në përputhje me ofertën fituese. Si kompani pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit, kompania “Security Code” Sh.P.K, ka përfunduar suksesshëm projekte të ngjashme ku kemi një staf të përkushtuar dhe të kualifikuar për të kryer detyrat e kërkuara, kjo vjen si rezultat i përkushtimit tonë dhe angazhimit në krijimin e kushteve adekuate për punëtorët tanë për realizimin e detyrave, e gjitha kjo e ndërlidhur po ashtu nga punëtorët të cilët në krahasimin e përvojave të tyre me kompanitë paraardhëse kanë ankesa për paga dhe trajtim të padrejtë në vendin e punës. Në kontratën për shërbime në bazë të Rregullores së KRPP-së neni 18.3 në tabelën e paraqitur për Informatat obligative të kërkuara gjatë kompletimit të Dosjes së Tenderit, në lidhje me LPP, është si në vijim: “Një kontratë për shërbime do të përfshijë: “obligimet e një Operatori në lidhje me kujdesin dhe mbikëqyrjen e pronës së AK-së, që është në shfrytëzim gjatë implementimit të kontratës”, si rrjedhojë OE i rekomanduar nga AK me çmimin e ofertuar si të papërgjegjshëm nuk do të arrijë në përmbushjen e implementimit të kësaj kontrate”. Në analizën nga dokumentet e po këtyre OE bëhet i qartë fakti se asnjëra nga OE nuk do arrijë të përmbushë obligimet e kësaj kontrate dhe implementimit të saj të parashikuar sipas kontratës. Në kontratën për shërbime në bazë të Rregullores së KRPP-së neni 18.3 në tabelën e paraqitur për Informatat obligative të kërkuara gjatë kompletimit të Dosjes së Tenderit, në lidhje me LPP, është si në vijim: Një kontratë për shërbime do të përfshijë: “obligimet e një Operatori në lidhje me kujdesin dhe mbikëqyrjen e pronës së AK-së, që është në shfrytëzim gjatë implementimit të kontratës”, si rrjedhojë OE i rekomanduar nga AK me çmimin e ofertuar si të papërgjegjshëm nuk do të arrijë në përmbushjen e implementimit të kësaj kontrate. Provë 1: Vendimi i AK dhe Njoftim mbi vendimin e AK.

Pretendimi i dytë (II), Ankuesi pretendon se: Argument: Neni 17 - Paqartësitë dhe mos-përputhjet në llogaritjen e kosto shpenzimeve janë evidente për shkak se OE fitues duhet të paguajë punëtorët me pagë bazë të përcaktuar sipas AK në vlerë prej 294.00€ Bruto, duke vijuar me respektimin e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, për pagën shtesë për orë të natës, vikend, festa dhe orë shtesë të cilat janë të përcaktuara në nenin 56 të Ligjit të Punës, si dhe pushimet të

përcaktuara në nenin 32 të këtij neni, që në këtë rast AK në DT ka caktuar Pragun ose Vijën e Kuqe që asnjë OE nuk mundet dhe madje nuk guxon të hyjë apo ofrojë një ofertë financiare nën këtë pragë të vendosur në DT. Këto janë shpenzime bazike për ofrimin e shërbimeve të sigurimit fizik ku në si OE nga llogaritja nga Departamenti i Financave të Kompanisë sonë kemi vërejtur mospërputhje të kosto shpenzimeve të cilat duhet të përfshihen në vlerën e kontratës. Nga mungesa e llogaritjes së këtyre specifikave të rëndësishme dhe të qarta për kriteret e llogaritjes ka sjellë vështirësi për ne si OE dhe avantazh për OE tjerë në kuptimin dhe krahasimin e ofertave nga aplikuesit. Sa i përket analizës financiare të paraqitur nga OE fitues, ka pasuar një mospërputhje serioze me Ligjin e Punës, në mënyrë specifike në aspektin e llogaritjes së orëve të punës gjatë festave, orëve të natës dhe pushimet vjetore. Ky gabim i shprehur në llogaritje për të ardhur deri tek çmimi final ka pasuar në një çmim të pasakte dhe të papërgjegjshëm të OE të lartcekur. Ligji i Punës Nr.03/L-212 dhe rregullore tjera të aplikueshme përcaktojnë qartë kriteret për pagesën e punonjësve gjatë këtyre periudhave, gabimet në llogaritjen e orëve të punës gjatë festave, orëve të natës dhe pushimeve vjetore kanë sjellë një shkelje të dukshme të Ligjit të Punës, pasi që OE ka detyrim ligjor për të siguruar se të gjitha pagesat dhe beneficionet e punëtorëve llogariten me saktësi dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Gjithashtu, duke konsideruar edhe deklaratën e OE fitues se do të respektojë Ligjin e Punës dhe rregulloret tjera, vërejmë një kundërshtim mes deklaratës dhe ofertës. Për të qartësuar më shumë të lartcekurat, të bashkangjitur gjeni një analizë të përgatitur nga Departamenti i Financave të Kompanisë sonë, ku fitimi i kompanisë është baraz me zero (0) dhe prapë shihet qartë se OE fitues është nën pragun e lejuar dhe të përcaktuar nga në DT nga AK të ofertimit ku oferta e tyre është 2.15€, kurse shembullin e llogaritjes nga ana jonë duke hequr fitimin e kompanisë del të jetë 2.49€. Provë 2: Analiza Financiare nga kompania jonë me kosto të fitimit zero (0).

Pretendimi i tretë (III), Ankuesi pretendon se: Argument: Neni 59 - Vlerësimi i tenderëve nga AK për OE nuk garanton një proces të rregullt dhe real për kompanitë pjesëmarrëse duke dëmtuar kompaninë tonë për mos fitimin e këtij tenderi dhe duke dëmtuar natyrën e konkurrencës së pjesëmarrjes nga OE, pasi OE tjerë i është krijuar një avantazh i pavend dhe sigurojmë se llogaritja për të ardhur deri tek çmimi final përmban të dhëna jo korrekte të cilat janë efektet kryesore që kanë shkaktuar lajthitje në llogaritjen përfundimtare për të shpërblyer me kontratë OE fitues. Paqartësia në kriteret e llogaritjes inkriminon OE që në analizat e tyre të japin çmime “fiktive” e të cilat nuk janë të argumentuara dhe të mbështetura se si do të kryheshin shpenzimet e cekura, pasi që kjo do të mund të konsiderohej si çmim më i ulët dhe i cili është edhe i papërgjegjshëm por obligimet të cilat do të dalin nga kjo kontratë nuk do të mund të mbuloreshin asesi me çmimin e ofertuar nga disa kompani tjera por do të shkaktonin proces jo të rregullt në zbatimin dhe menaxhimin e kontratës në fjalë. Pasi që vlerësojmë se sipas nenit 59 par.4: “Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”, atëherë oferta fituese është e papërgjegjshme për të kryer shërbimet e sigurimit fizik. Ndërsa, sa i përket OE pjesëmarrës “SAS” Security vërejmë se OE në pasqyrat e ngarkuara në sistem shihet qartë se biznesi në fjalë ka operuar me humbje në dy vitet e fundit (d.m.th. nuk ka likuiditet), gjithashtu auditori i certifikuar nuk ka të drejte ligjore për të bërë rishikimin e pasqyrave financiare që ata e kanë bërë, por duhet t’u bej kompania ligjore e auditimit, ashtu siç edhe ceket në DT. Sepse siç edhe shihet, raporti në fjalë nuk është dorëzuar në Këshillin Kosovar për Raportim Financiare, do të thotë nuk ka vulë të protokoluar që e dëshmon dorëzimin në fjalë në KKRF. Në vlerësimin e analizës financiare nga ana jonë me kosto të fitimit zero (0), vërejmë se OE “Rojet e Nderit” kanë tenderuar nën prag të çmimit të përcaktuar nga AK në DT. Gjithashtu, OE nuk ka stabilitetin e mjaftueshëm financiar dhe ekonomik për të performuar kontratën e propozuar, i njëjti është në vonesë për shlyerjen të

borxhit në ATK si dhe OE ka vonesa të pagave të punonjësve më shumë se 90 ditë dhe e cila mund të verifikohet nga AK me kërkesë në institucionet relevante, OE paraardhës i sigurimit të objekteve shëndetësorë të KPSH ka neglizhuar afatet në pagesat mujore të punëtorëve, ka pasur ngecje në plotësimin e plotë të kushteve të tyre me ç ‘rast ka ndikuar në revoltimin dhe performancën e tyre në objektet shëndetësore dhe si i tillë nuk do të mund të implementojë kontratën e parashikuar sipas kushteve të caktuara dhe deklaratave të dhëna. Provë 3: Kërkesat e AK në DT – saktësisht: 9.1&9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Provë 4: Raporti i “SAS” SH.P.K i cili operon me humbje (nuk ka likuiditet).

Pretendimi i katërt (IV), Ankuesi pretendon se: Argument: Neni 60 - Disa OE kanë aplikuar kritere të ndryshme nga ajo e kërkuar nga AK në fund duke dalur si OE të cilët kanë çmim më të ulët në ofertimin e tyre duke ndikuar në barazinë dhe objektivitetin e procesit të tenderit. Në vlerësimin e Komisionit Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave ka një zbrazëti në procesin e llogaritjes së çmimeve përfundimtare për shkak se kriteret e AK nuk janë në harmoni me ofertën e OE, ku sipas nenit 60 par.1 theksohet: “Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1. tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët”. Në përputhje me këtë nen AK ka shpallur fitues një OE i cili në tenderin e tij është i papërgjegjshëm në çmim.

Pretendimi i pestë (V), Ankuesi pretendon se: Argument: Neni 69 – Pas një shqyrtimi të hollësishëm të dokumenteve të OE fitues, vërejmë një mungesë të dukshme të aftësisë teknike dhe profesionale në shpërblimin e kontratës, mungesë kjo e cila ka ndikim negative në cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve të ofruara për objektet shëndetësore. Në nenin 69 par.4 theksohet të paraqitur edhe në kërkesën për rishqyrtim tregohet: “Në procedurat që shpërndihen në dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë të dhënat me të cilat dëshkohet aftësia e tyre për sigurimin e këtyre shërbimeve; në veçanti, të dhënat mund të kërkojnë lidhur me shkathhtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën dhe besueshmërinë. Të dhënat përkitazi me aftësitë teknike të operatorëve ekonomik mund të parashtrihen përmes një ose më shumë mjeteve në vijim, sipas llojit, sasisë dhe qëllimit të shërbimeve që duhet të furnizohen”. Nga OE vet mungesa e mosngarkimit të dokumenteve të kërkuara, dhe hartimit të mangët të analizës financiare e cila bie në kundërshtim me deklaratat e tyre e vërejmë se aftësitë profesionale nuk kanë kualifikimin e duhur për të menaxhuar me këtë kontratë, duke theksuar shprehimisht se OE në deklaratë shprehet edhe për pagesën e 11 punëtorëve të AK të theksuar në dosje të tenderit, saktësisht tek FTD Kapaciteti teknik dhe profesional, dëshmia e kërkuar dokumentare citoj: “OE duhet të deklarohet se do të punësoj minimum 84 roje sigurie për kryerjen e shërbimeve; nga të cilët 11 prej tyre do të jenë punëtorët ekzistues të Autoritetit Kontraktues. Pagesa mujore totale momentale për përvojën e punë të të 11 punëtorëve ekzistues është 275.25€ (pa TVSH). Kjo pagesë duhet llogaritur të paguhet për çdo muaj”. Për ne si OE është habitëse se si AK edhe në procedurën e vlerësimit e cila përfshin 3 faza dhe atë: 1. Vlerësim të përshtatshmërisë dhe kualifikimit të ofertuesve; 2. Vlerësimi teknik i tenderit dhe 3. Vlerësimi financiar, OE kanë mundur të kalojnë të tërë këto faza nga komisioni duke mos i hetuar mangësitë e tyre në ofertën e paraqitur dhe madje të shpallë fitues OE “King Security”, duke ditur se ekziston një dallim i qartë në mes të kritereve të dhënies e cila si karakteristikë duhet të lidhet në mënyrë strikte me karakteristikat e lëndës së kontratës dhe kritereve të përzgjedhjes të cilat kanë të bëjnë me kualifikimet dhe kapacitetet e tenderuesit, kritere këto të cilat OE nuk i përmbushin në tërësi. Provë 5: Kërkesat e AK në DT – saktësisht: 9.1&9.2 – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Security Code Sh.P.K.” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 17, 59, 60, 69 të LPP –së. OE propozon që të aprovohet si e bazuar ankesa e OE “Security Code” Sh.P.K dhe të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së për aktivitetin e prokurimit dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, me ç’rast pas elaborimit të ofertave të shpërblehet OE e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 30.10.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 794/23, ndërsa me datë 11.11.2023 është dorëzuar raport i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/794 me rekomandimet si në vijim;

Lidhur me pretendimet e OE “Security Code Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/794 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te bëjë me nenin 7 te LPP-se dhe vlerësimin e ofertave te cilat kanë qenë pjesëmarrëse në aktivitet të prokurimit me theks të veçantë ne ofertën e rekomanduar për kontrate eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues në pretendimin e tij nuk ka dhënë asnjë argument apo dëshmi për shkeljen e supozuar te AK-se. Për më tepër OE ankues i referohet se “ka pasur indikacione se OE është trajtuar ndryshe dhe nuk ka pasur mundësi te trajtimit te barabarte.”

Konstatimi i dytë (II): “Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me llogaritjen e orëve te punës, festave dhe orëve te natës eksperti shqyrtues sqaron se me specifikimin teknik te dosjes e tenderit është kërkuar: Me qëllim të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të punëtorëve, OE është i obliguar që të respektoj të gjitha të drejtat të cilat dalin nga ligji i punës, rregulloret dhe udhëzimeve tjera në fuqi. Për të qartësuar pagën e punëtorëve, ne ju sqarojmë si më poshtë: • Për pika 24 orëshe kemi vetëm 8 orë të ndërrimit të natës. • Për pika 8 orëshe kemi vetëm orë të ditës. Kurse për të nxjerrur numër të punëtorëve duhet kalkuluar si vijon sipas udhëzimit të MPMS Nr/09/2017 ku fondi I orëve për një punëtor është 176 orë, dmth numëri total i orëve për secilin pikë /176 jep numër të punëtorëve. OE janë të obliguar të paraqesin analizë financiare për secilin pozicion dmth 8 orësh, dhe 24 orësh, orëve të ndërrimit të natës (8 orë, të cilat duhet të paguhen 30% më shumë se ora e rregullt e punës, nga ora 22 deri në orën 06), orëve të ditëve festive, të gjitha në bazë të ligjit të punës. OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar një analize te thjeshte financiare duke mos e dhënë analizën për secilin pozicion sipas kërkesës se specifikimit teknik. Analiza e OE te rekomanduar për kontrate nuk është ne përputhje me kërkesën e Aneks I -Specifikimet Teknike Te Detyrueshme për te paraqitur analizë financiare për secilin pozicion dmth 8 orësh, dhe 24 orësh, orëve të ndërrimit të natës (8 orë, të cilat duhet të paguhen 30% më shumë se ora e rregullt e punës, nga ora 22 deri në orën 06), orëve të ditëve festive, të gjitha në bazë të ligjit të punës. Eksperti shqyrtues vlerëson se dosja e tenderit është përpiluar ne përputhje me nenin 19.3 te RRPP 001/2022 dhe ka qenë obligative për te gjithë OE pjesë të aktivitetit te prokurimit sipas kërkesave te RRPP neni 19 paragrafi 11. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk e ka vlerësuar ofertën e OE te rekomanduar për kontratë në përputhje me nenin 59 paragrafi 4 i LPP-se dhe se pretendimi ankimor i OE ankues në këtë pikë është i bazuar. OE ankues përveç faktit se ka deklaruar se Oferta fituese nuk i ka përmbushur te gjitha detyrimet e specifikuar ne DT dhe përshkrimit te përvojës se OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit nuk janë dhënë konkretisht faktet dhe argumentet te mbështetura ne shkelje dhe te argumentuara me LPP dhe RRPP për pretendimin e tij prandaj eksperti shqyrtues

për këtë pretendim nuk mund të jap ndonjë vlerësim.”

Konstatimi i tretë (III): “Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me pasqyrat financiare dhe likuiditetin financiar të OE të atakuar nga OE ankues eksperti shqyrtues vlerëson se me dosjen e tenderit është kërkuar: Sqarim: AK-ja në kërkesën Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: OE-ik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit minimum 750,000.00 euro. Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo në vendin e themelimit apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur. Me datën 21.07.2023 ka ngarkuar në sistem të e-prokurimit sqarimin e dosjes së tenderit ku si dëshmi për kërkesën si me lartë është ndryshuar me “OE duhet të plotësoj dhe dorëzoj një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.” Ndryshimi nuk ishte reflektuar edhe në dosjen e tenderit. Prandaj duke u bazuar në dosjen e tenderit, kërkesën për sqarim eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues nuk është pjesë e FDT rrjedhimisht vlerëson se pretendimi nuk është i qëndrueshëm. OE ankues në pjesën e dytë të pretendimit ku i referohet OE se nuk ka stabilitet të mjaftueshëm financiar dhe rregullimin e brendshëm të kompanisë eksperti shqyrtues vlerëson se kjo nuk ka qenë pjesë e kërkesave të dosjes së tenderit apo vlerësimit të komisionit dhe se pretendimi nuk është i qëndrueshëm. Prandaj duke u bazuar në sqarimet si me lartë eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi nuk është i bazuar.”

Konstatimi i katërt (IV): “Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me nenin 69 të LPP-se dhe pretendimeve që kanë të bëjnë me analizën financiare eksperti shqyrtues vlerëson se kjo çështje është adresuar dhe i është dhënë përgjigje nën pretendimin e tretë ndërsa sa i përket pjesës tjetër të pretendimit eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues përveç vlerësimeve të përgjithshme nuk ka dhënë dëshmi të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij apo argumente për shkeljet të mbështetura dhe të argumentuara me LPP dhe RRPP. Prandaj në mungesë të fakteve dhe argumenteve mbi shkeljet eksperti shqyrtues nuk mund të jap ndonjë vlerësim të mbështetur në LPP dhe RRPP.”

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura dhe pretendimet ankimore të lartcekura propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale mirëpo nuk janë deklaruar lidhur me raportin e pranuar nga eksperti shqyrtues përmes sistemit të e-prokurimit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtesat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

Paneli shqyrtues vlerëson se raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur

dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Argumentimi në raportin e ekspertës është nuk është i argumentuar në prova dhe fakte sa i përket pohimit ankimor për llogaritjen e orëve të punës, festave dhe orëve të natës nga autoriteti kontraktues. Sepse nuk jep një konstatim të saktë të gjendjes reale të kësaj pike, edhe aspak nuk ju referohet edhe vendimeve paraprake të OSHP për mënyrën e trajtimit të kësaj çështje, por vetëm vjen me një përfundim ekspertit se *“OE i rekomanduar për kontrate ka prezantuar një analizë të thjeshtë financiare duke mos e dhënë analizën për secilin pozicion sipas kërkesës së specifikimit teknik. Analiza e OE të rekomanduar për kontrate nuk është në përputhje me kërkesën e Aneks I -Specifikimet Teknike Te Detyrueshme për të paraqitur analizë financiare për secilin pozicion”*. Po ashtu, eksperti nuk ndalet edhe tek analizat tjera për të cilat ankuesi ka potencuar në ankesën e tij *“Në analizën nga dokumentet e po këtyre OE bëhet i qartë fakti se asnjëra nga OE nuk do arrijë të përmbushë obligimet e kësaj kontrate dhe implementimit të saj të parashikuar sipas kontratës”*. Po mos ta kishte potencuar këtë faktë ankuesi në ankesën e tij atëherë do të duhej të klasifikohesh si pale pa interes për këtë aktivitet të prokurimit konform nenit 4.1.26 të LPP si dhe njoftimit të publikuar në ueb faqen e OSHP, ngase, aty potencohet se nëse ankuesi nuk i atakon të gjithë OE të cilët janë të përgjegjshëm dhe janë të radhitur para tij me vlerë më të ulët atëherë është pale pa interes. Kështu që, paneli shqyrtues nuk mund ta mbështet raportin e ekspertizës në këtë rast.

Paneli shqyrtues pasi që analizoi në tërësi të gjitha shkresat e kësaj lënde, si dhe duke mos pasur mundësi të bëjë një analizë financiare, të cilën as eksperti nuk e ka bërë vendosi që ta anuloi aktivitetin e prokurimit, për faktin se AK nuk ka parashtruar drejtë kërkesat e Dosjes së Tenderit duke mos përcaktuar saktë, numrin e orëve të punës (orët e rregullta, orët e natës, orët e festave dhe orët e vikendeve). Sikur të bëhej kjo ndarje e orëve atëherë secila palë po ashtu edhe eksperti, do të kishin mundësi ta bënë analizën e saktë financiare duke e pasur për bazë secilin lloj të orëve të punës dhe konform ligjit të punës. Po ashtu, edhe në konsistencë të vendimeve 138/23;143/23;192/23;369/23. Për shkak se është shumë e vështirë të përcaktohet një vlerësim i saktë i gjendjes. Për panelin shqyrtues por edhe për secilën pale është vështirë të merret vendim meritore se në bazë të kalkulimeve nëse ndonjëra palë mund të arrijë ta plotësojë kushtin e Dosjes së Tenderit. Po ashtu, është fakt notor se 9 ofertat e paraqitura në këtë aktivitet të Prokurimit kanë një diskrepancë të madhe me vlerën e parashikuar nga AK për këtë aktivitet të Prokurimit, e ku supozohej se kjo vlerë vendoset pas një analize apo hulumtimi të tregut. Po ashtu, edhe vlera e OE të rekomanduar për kontratë i cili është më i liri ka një diferencë të madhe me OE ankuesi I cili ka vlerën për të lartë të paraqitur në këtë aktivitet dhe diferenca mes tyre është rreth 140,000.00€ euro, dhe për kontratë të shërbimeve dhe për këtë natyrë të aktivitetit dhe me kohëzgjatje prej 1 viti lë të kuptohet se Dosje e Tenderit nuk është hartuar mire dhe mund të keqpërdoret me një vendim ndryshe.

Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë. Pikat që Operatori Ekonomik duhet të sigurojë objektin/ vendin e punës 24h në ditë, objektin/vendin e punës 8h. Te caktoj page mujore Bruto, jo me te ulte se paga minimale sipas ligjit, ku pagës Neto duhet të i shtohet kontributi i punëdhënësit 5%, kontributi i punëtorit 5 % si dhe tatimi mbi paga, si do te llogaritet TVSH 18%.

Kështu që, paneli shqyrtues obligon AK që në rast të ritenderimit të këtij aktiviteti të Prokurimit, fillimisht të bëjë një hulumtim të saktë të tregut, të bëjë vet një analizë financiare, të përcaktoj saktë; Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë, Pikat që Operatori Ekonomik duhet të sigurojë objektin/ vendin e punës 24h në ditë, objektin/vendin e punës 8h. Te caktoj page mujore Bruto, jo me te ulte se paga minimale sipas ligjit, ku pagës Neto duhet të i shtohet kontributi i punëdhënësit 5%, kontributi i punëtorit 5 % si dhe tatimi mbi paga, si do te llogaritet TVSH 18%, konform rekomandimit në këtë vendim nga ana e panelit dhe të respektoj të gjitha ligjet në fuqi me qëllim që as OE të mos kenë mundësi ta keqpërdorin fuqinë punëtore.

- Përfundim -

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimi i ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të anulohet në tërësi, sepse në të kundërtën kjo do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në rivlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat 6 relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit. Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Security Code, Rojet E Nderit SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: